



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 976/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Ferizaj, paraqitur kundër koalicionit Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe Nismës Qytetare të Ferizajt (NQF), dega Ferizaj, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në Raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, kështu që koalicionit Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe Nisma Qytetare e Ferizajt (NQF) dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën shumë detyrohen ta paguajnë në mënyrë solidarë të dyja subjektet politike, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 01.12.2013, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se me datën 01.12.2013, në ora 09:23, partneri i koalicionit LDK – NQF, Z.Bashkim Fazliu – Migjeni, në ditën e votimit përmes telefonit të tij personal me nr.044/113-555, ka dërguar mesazhe telefonike me qëllim të ndikimit që të votojnë kandidatin e LDK-së, z. Muharrem Sfarqa, me të cilin veprim ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, Rregullën Zgjedhore nr.11/2013 Kodi i Mirësjelljes për subjektet politikë, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, neni 7 pika 7.1.(b), si dhe Ligji nr.03/L – 073, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 36.1 pika (b).Ankesës parashtruesi i ka bashkangjitur fotografitë me mesazhet telefonike.

PZAP-i, e informoi kryetarin e Nisma Qytetare për Ferizaj, NQF, Bashkim Fazliu, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 02.12.2013, për ankesën që është bërë, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 03.12.2013, deri në ora 12:00, sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga Bashkim Fazliu, kryetar nga radhët e NQF-së, në të cilën theksohet se ky është sms mes shokëve, si çdo komunikim tjetër, kur p.sh shkëmbehen urime edhe për festën e 28 Nëntorit. Këso sms thotë kam pranuar edhe unë dhe as që e kam pas idenë se diçka e tillë mund të përdoret si kundërgargument. Po ashtu në përgjigjen në ankesë theksohet ti referohen termit “Miqësisht”, pasi me të tregohet në SMS se i është dërgua shokut me një kërkesë miqësore – jo të

detyrueshme dhe as që të ndikohet. Aty po ashtu nuk ka gjuhë urrejtjeje apo çfarëdo gjuhe tjetër kundrejt kandidatëve tjerë, prandaj konsideroj se ankesa në fjalë është e pabazë dhe është përdorë qëllimisht kundër meje, theksohet në përgjigjen në ankesë nga Bashkim Fazliu.

PZAP-i, po ashtu e informoi subjektin politik LDK, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 02.12.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës, deri me datë 03.12.2013, deri në ora 12:00, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga LDK, sipas afatit të caktuar, në të cilën theksohet se, sa i përket ankesës së PDK- dega Ferizaj e datës 02.12.2013, ushtruar kundër LDK-së, vlerësojmë se kjo ankesë është e pabazë, e bërë për motive politike elektorale, gjithashtu në përgjigjen në ankesë theksohet se personi ndaj të cilit është bërë ankesa nuk është anëtar i subjektit politik LDK dhe për këtë arsye nuk mbajmë përgjegjësi për veprimin e mundshëm.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihen qartë se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 7.1 pika b), Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, dhe me nenin 36.1 pika b) të LZP-së, i cili përcakton se: Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili nga veprimet si bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Prandaj PZAP, duke pasur parasysh se nga partneri i koalicionit LDK- NQZ, Bashkim Fazliu kryetar i NQF-së, ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore duke bërë fushatë zgjedhore, ku në ditën e votimit me datë 01.12.2013, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, përmes telefonit të tij ka dërguar mesazhe elektronike, me qëllim të

përkrahjes dhe votimit të kandidatit të LDK-së Muharrem Sfarqa, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore ,të nenit 7.1 pika b), Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, dhe me nenin 36.1 pika b) të LZP-së, si dhe duke pasur parasysh faktorët e cekur me lartë, PZAP, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 976/2013 më datën 04.12.2013.



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*